



Xhani De Biazi dhe Shqiperia e futbollit jane gjithmone e me larg. Traineri italian ka lene Tiranen per tu rikthyer ne shtepi dhe tani duket se do te marre nje tjeter oferte nga Armando Duka. 10 perqind me pak nga cfare ka marre edicionin qe u mbyll. Kjo eshte oferta qe FSHF po pergatit per italianin dhe pritet qe tja dergoj me faks ate ne shtepi per ta pare dhe per te vendosur me pas nese do te nenshkruaj apo do te largohet perfundimisht. 30 perqind me shume kishte kerkuar De Biazi, 10 perqind i ofroi Duka deri para ndeshjeve qe u humben me Islanden, Sllovenine dhe Zvicren. Barazimi ne Qipro ka prishur perfundimisht humorin e presidentit qe tani duket se nuk e shikon me si me pare De Biazin. Divorci duket gjithmone e me prane.